

Sa po i kushtojmë kujdes pastërtisë së gjuhës shqipe?

Sami ISLAMI

7 maj 2009

Përmbledhje

Në këtë shkrim flitet për përdorimin e tepruar e të panevojshëm të fjalëve të huaja në gjuhën e sotme shqipe dhe mundësinë e zëvendësimit të tyre, sa herë që është e mundur, me fjalë e shprehje të bukura burimore shqipe.

Gjuha bashkë me kulturën, traditën e historinë krijojnë strumbullarin dallues dhe karakteristik të çdo populli. Si veçori me rëndësi tepër të madhe ajo pothuaj tek të gjithë popujt e civilizuar ruhet me një fanatizëm të madh. Kjo praktikë duhet ndjekur edhe për gjuhën shqipe, sepse duke e ruajtur gjuhën të pastër, por edhe elementet e tjera që i përmendëm, ruhet edhe kombi, kultura, tradita... . Mirëpo gjuha si organizëm i gjallë zhvillohet e pasurohet krahas zhvillimit të kombit. Ajo ecën paralel me zhvillimin e shkencës, kulturës, teknikës duke u pasuruar me fjalë të reja, të krijuara këto nga fondi i vet, ose duke i marrë nga gjuhë të tjera, por gjithnjë duke ia përshtatur ato vetes. Kjo gjë është krejt normale për secilën gjuhë, por në gjuhët e zhvilluara fjalët e reja (dhe ato të huazuara) nuk mund të hyjnë, do të thoshim, pa kriter dhe dosido, siç po ndodh në një masë mjaft të madhe në gjuhën tonë sot. Duke e vështruar këtë dukuri në mediat e shkruara dhe ato elektronike fiton përshtypjen sikur mediat po bëjnë gara se cila do të marrë më shumë fjalë të huaja për t'u dukur më "moderne", më "bashkëkohore"? a..., ec e merre vesh. Kjo dukuri nuk është vështirë të hetohet jo vetëm nga gjuhëtarët, por as nga njerëzit e profesioneve të tjera, madje edhe prej njerëzve të rëndomtë. Po t'i hedhim një sy gjuhës së mediave tona p. sh. do të tronditemi nga vërshimi i fjalëve të huaja, që një lexues i rëndomtë shqiptar, nëse do që ta kuptojë se çfarë shkruajnë gazetatat ose se ç'thuhet në mediat elektronike, mund të themi se më mirë do t'i binte që të merrte fjalorin e fjalëve të huaja me vete! (se Fjalorin e Gjuhës Shqipe as të mos flasim!) Dhe jo vetëm një fjalor, por nja pesë a gjashtë! Thënë shkurt, po t'i shikojë lajmet shqip një i huaj dhe një shqiptar, më lehtë do t'i kuptojë i huaji (edhe në qoftë se nuk e di mirë gjuhën shqipe) se vetë shqiptari, i cili nuk ka një arsimim bukur të lartë dhe i cili nuk di një, dy a me shumë gjuhë të huaja!

Siç thamë në fillim, fjalët e huaja kur hyjnë në gjuhët e tjera p. sh. në gjuhët perëndimore, në gjuhën angleze, frënge, gjermane etj. hyjnë me kriteret e caktuara (ato vëzhgohen nga njerëzit kompetentë, pra nga gjuhëtarët). Dhe nëse ajo fjalë përdoret

në gjuhë për një vit, fjala e tillë "përvetësohet" bile futet në fjalor. Pra shpjegohet kuptimi i saj dhe njerëzit mund ta përdorin edhe fjalën vendëse por edhe atë të huaj, të cilat më nuk janë të "huaja" por autoktone. Në gjuhën shqipe situata është krejt ndryshe. Fjalët e huaja futen në gjuhë pa asnjë kontroll. Ato përdoren jo një vit a dy, por me vite dhe askush nuk kujdeset për to. Gati asnjë prej këtyre fjalëve që do t'i marrim në shqyrtim nuk janë në fjalor. Kot e ka nxënësi, studenti apo kushdo tjetër të shfletojë fjalorin e gjuhës shqipe, siç thamë më lart, e t'i kërkojë këto fjalë, sepse nuk mund t'i gjejë. Kurse në anën tjetër këto fjalë i kanë vërshtuar të gjitha segmentet e jetës shqiptare, në rend të parë mediat. Sa për ilustrim po i përmendim disa fjalë që na bie shpesh t'i ndeshim në mediat tona: **hezitohet (hezitim), involvohet (involvim), prononcimet (prononcim), trajtohet (trajnim), relaksohet (relaksim), negociohet (negocim), menagjohet (menagjim), fascionohet (fascionim), suprimohet (suprimim), implementohet (implimentim), konspirohet (konspirim) konspiracion; pastaj logjistikë, fiasko, balotazh, fiskal, akses, rule, trojkë, zbor, bord, konvoj, staf, bodigard, fleksibil, okular** etj., etj.

Duke i shikuar këto fjalë më me kujdes shohim se këto "u volën" nga shumë gjuhë të tjera evropiane, dhe u futën në gjuhën shqipe duke filluar prej gjuhëve të vjetra latine e greke, nga e cila kanë marrë fjalë edhe gjuhët e tjera e deri tek gjuha angleze, frënge, italiane apo ruse. Për t'i shqyrtuar pak më mirë do t'i ndajmë në disa grupe:

1. Në grupin e parë i kemi futur disa fjalë që kanë hyrë në gjuhën shqipe nga latinishtja. Kështu pra gjuha shqipe, ashtu sikur edhe gjuhët e tjera, ka marrë fjalë nga kjo gjuhë, që edhe po të duam ne nuk do të mund t'i "përrjashtojmë", por ka edhe të tilla që edhe mund të largohen, sepse fjalë të tilla ekzistojnë në gjuhën tonë. Në këtë kontekst do t'i përmendim disa fjalë, të cilat janë duke u përdorur pa nevojë mjaft dendur, sidomos në mjetet e informimit. Fjalë të tilla janë: **implementohet (implementim), fascionohet (fascionim), suprimohet (suprimim), fiskal-e, fleksibil-e, okular-e, konspiracion** etj.

Meqë në gjuhën shqipe kemi fjalët burimore për këto terma, jemi të mendimit që fjala shqipe do të duhej të kishte vendin kryesor. Kështu për *implementohet* (implementim) mund të përdoret fjala shqipe **kryej, përmbush, zbatohet** (P. sh. në vend të: "*U implementua* plani për zhvillim", të themi: "**U përmbush, u zbatua** plani për zhvillim" etj.) për *fascionohet* (*fascionim*), **mahnit apo magjeps** ("Më **ka mahnitur** talenti i ...", për "Më *ka fascionuar* talenti i ..."); për fjalën *suprimohet* (suprimim) do t'i përdorim fjalët **heq, tërheq** (p. sh. fjalën etj.), **asgjësoj** etj. (P.sh. "**Iu hoq e drejta e fjalës**", për "*Iu suprimua* e drejta e fjalës"); për *fiskal* kemi fjalën **financiar-e** (që ka të bëjë me financat e një shteti, ndërmarrjeje, individi etj.). P.sh. "Në vendin tonë u dëmtua **sistemi financiar**", për: "Në vendin tonë u dëmtua *sistemi fiskal*"; për *fleksibil* kemi fjalët shqipe **i lakueshëm (e lakueshme), i përkulshëm (e përkulshme), i epushëm (e epushme), që lëshon pe** etj. Prandaj mund të themi p. sh. "Ky njeri **nuk lëshon pe, ose nuk është i përkulshëm**", për "Ky njeri *nuk është fleksibil*". Në këtë mënyrë duhet të trajtohet edhe fjala *fleksibilitet*, etj.

Për fjalën *okular* nga latinishtja *oculus* që do të thotë *sy*, mund të hasësh këso konstruktsh "Sipas dëshmitarit *okular*, aksidenti ndodhi pikërisht në mesditë", për: "Sipas dëshmitarit **që e pa ngjarjen**, ose që ishte **i pranishëm**, aksidenti ndodhi pikërisht

në mesditë". Fjalën *konspiracion* (emër) shqip mund ta themi thjesht me **fshehtësi e madhe, punë ilegale** p. sh. "Aksioni u bë **në fshehtësi të plotë**", për: "Aksioni u bë në *konspiracion të plotë*" etj.

2. Në grupin e dytë i kemi marrë disa fjalë që janë të origjinës angleze, e që, në kohë të fundit, janë duke u përdorur me të madhe në gjuhën tonë, sidomos në gjuhën e radios, televizionit dhe të shtypit të përditshëm. Ja disa sosh: **hezitohj (hezitim), involvoj (involvim), trajnoj (trajnim), relaksoj (relaksim), menagjoj (menagjim), akceptoj (akceptim); pastaj akces, bord, staf, bodigard** etj.

Për fjalën *hezitohj* (hezitim) e kemi fjalën **ngurroj (ngurrim)** dhe nuk shoh arsye që të flaket kjo fjalë nga thesari i gjuhës shqipe për ta marrë një fjalë të huaj, që në këtë rast është krejt e panevojshme. Pra në vend të "Ai *po heziton* të thotë diçka", mund të thuhet thjesht shqip "Ai **po ngurron** të thotë diçka" etj. Në anën tjetër, fjala *involvoj (involvim)*, po ashtu mund të largohet nga përdorimi, sepse ne e kemi fjalën tonë për këtë kuptim: **përfshij, ndërlikoj, ngatërroj** etj. P. sh.: "Në aksident *u involvuan* katër veta", shqip do të thoshim "Në aksident u **përfshinë (u ngatërruan, u futën** etj.) katër veta". Ose për fjalën *trajnoj (trajnim)*, për të cilën është bërë fjalë edhe më parë, mund të themi se do të ishte mjaft e qëlluar sikur të vazhdohet të përdoren fjalët shqipe **aftësoj (aftësim) ose stërvit (stërvitje)**. Pra, t'i largojmë menjëherë fjalët *trajnoj, trajnim, trajnues* dhe në vend të tyre t'i përdorim fjalët: **aftësoj, aftësim, aftësues ose stërvit, stërvitje, stërvitës**. P. sh. "Përfundoi **aftësimi (ose stërvitja)** e gjeneratës së pestë të policisë kosovare", për: "Përfundoi *trajnimi* i gjeneratës së..." Ose: "Në kursin veror morën pjesë 60 **stërvitës (ose aftësues)**", për: "Në kursin veror morën pjesë 60 *trainues*!?" etj. etj.

Fjala *relaks* në gjuhën angleze ka disa kuptime, si **dobësoj, zbut, lehtësoj, liroj, lëshoj, çlodh, qetësoj, shtendos** etj., por në gjuhën shqipe po përdoret kryesisht për të shprehur kuptimin e **çlodhjes apo të pushimit**. P. sh. në vend të "**Për pushim, çlodhje të mirë**" (reklamë) del "Për *relaks* të mirë"! etj.

Kuptimi i fjalës *menagjoj* mund të perifrazohet në shqip me **ia dal mbanë di të përdor** (një vegël, armë, aparat etj.), prandaj jo: "A mund të *menagjosh* me këto punë"?, apo "A di të *menagjosh* me këtë vegël"?, por "A mund t'ia **dalësh** me këto punë"?, apo "A di **ta përdorosh** këtë vegël" etj.

Për fjalën *akceptoj* do të përdorim fjalën shqipe **pranoj marr**. Pra jo: "Kushtet e kërkuara *do të akceptohen*", por: "Kushtet e kërkuara **do të pranohen**", ose jo: "Sjellja e tij është *e paakceptueshme*"(!?)", por: "Sjellja e tij është **e papranueshme**" etj.

Fjala tjetër *akses* mund të zëvendësohet me fjalët shqipe: **lidhje, hyrje** etj. P. sh. "A ka **ndonjë hyrje** tjetër në këtë ndërtesë?", e jo: "A ka *ndonjë akses* tjetër në këtë ndërtesë ? etj.

Në kohë të fundit është duke u përdorur mjaft me të madhe edhe fjala *bord*. Kjo fjalë është duke e "përrjashtuar" pa të drejtë fjalën tonë **këshill** (P. sh. "Drejtori u takua me *bordin* e shkollës", në vend: "Drejtori u takua me **këshillin** e shkollës.") etj. Vlen të përmendet me këtë rast edhe fjala *staf*, që po përdoret në vend të fjalës "personel", p. sh. Jo: "Gjithë *stafi* i ndërmarrjes është me përgatitje të lartë shkollore", por: "Gjithë **personeli** i ndërmarrjes është me përgatitje të lartë shkollore".

Në vend të fjalës shqipe **truproje** shpesh po e ndeshim të shkruar dhe të folur fjalën

angleze *bodigard* (pra nga ang. *body* "trup(ë)" dhe *guard-* "roje"). Kështu në vend "Ministri doli i rrethuar nga *bodigardët*", do të ishte e drejtë të thuhej "Ministri doli i rrethuar nga trupërojet" etj.

3. Një numër i "*huazimeve*", në shqipe hyri nga gjuha frënge. Nga kjo gjuhë në kohë të fundit janë duke u përdorur disa fjalë, të cilat vetëm sa po e ngarkojnë gjuhën tonë. Njëra nga këto është fjala *prononcoj* (*prononcim*), e cila ka marrë përdorim të gjerë, sidomos në mjetet e informimit. Kuptimi i kësaj fjale në shqip është: **deklaroj, theksoj, them** etj. P. sh. "N. N. **deklaroi** për RTK-në", e jo "N. N. *u pronocua* për RTK-në" etj. "E morëm *prononcim*in edhe të ministrit", në vend: "E morëm **deklaratën** edhe të ministrit" etj.

Në kohën e zgjedhjeve që u bënë në Shqipëri, kohë më parë, më ka rënë të dëgjoj edhe fjalën frënge *balotazh*, e cila s'është asgjë tjetër pos fjalë e përdorur në vend të fjalës shqipe **votim** ose **votim i fshehtë**. Pra, në vend "**Votimi** përfundoi pa probleme", del me "*Balotazhi* përfundoi pa probleme",

Fjala tjetër, po ashtu me origjinë frënge, fjala *konvoj* ka kuptimin e **kolonës, vargut**. Kjo fjalë po përdoret kryesisht në sferën ushtarake (po jo vetëm këtu), që ka të bëjë me përcjelljen e njësisive të veçanta ushtarake, autoblanda, kamionë etj. Pra: "**Kolona** ose **vargu** i autoblandave", e jo "*Konvoji* i autoblandave" ose "**Kolona** ose **vargu** automjeteve" etj., por jo "*Konvoji* i automjeteve" etj..

4. Ka pak fjalë në gjuhën shqipe, të cilat kanë hyrë edhe nga italishtja e sotme, siç është fjala *fiasko*, që përdoret në ato treva shqiptare, ku italishtja ka ndikim më të madh, sidomos në disa treva të Shqipërisë, ku mediat italiane kanë një ndikim më të madh. Kuptimi i kësaj fjale shpjegohet me "**mossukses i madh**", "**turp**", "**shkatërrim**" etj. Prandaj në vend të "N. N. pësoi *fiasko* të madhe", lehtë mund të thuhet shqip "N. N. pësoi **humbje të madhe, mossukses të madh**" etj.

5. Në këtë vazhdë ka fjalë që në gjuhën shqipe u futën edhe nga rusishtja. Kjo ndodhi sidomos në kohën e komunizmit dhe vazhduan të përdoren edhe deri në ditët e sotme. Fjalë të tilla, sidomos më ka rënë t'i dëgjoj në mediat nga Shqipëria. Kjo mbase ndodhi për arsye se gjatë komunizmit Shqipëria kishte marrëdhënie të mira ekonomike, kulturore e politike me ish Bashkimin Sovjetik. Në këtë kohë u futën edhe fjalët *trojkë, zbor* e ndonjë tjetër, të cilat përdoren ende aty- këtu edhe sot. P. sh. "U takua *trojka* evropiane" "Rezultatet e *trojkës* ishin shpresëdhënëse". Në Kosovë këto fjalë nuk kanë mundur të hyjnë, për arsye se shqiptarët e Kosovës e ndienin këtë ndikim shumë më tepër dhe i luftonin këto me çdo mjet. Kurse në Shqipëri për shkak të mosekzistimit të kontaktit të drejtpërdrejtë me gjuhët sllave, u futën më lehtë. Pa u zgjeruar në këtë segment do të thoshim se shqip këto trajta duhej të dilnin kështu: "U takua **treshi** evropian" dhe "Rezultatet e **treshës** ishin shpresëdhënëse". Po ashtu edhe fjala *zbor*, s'është gjë tjetër por "zëvendësim" i fjalës shqipe **tubim mbledhje** dhe si të tillë nuk bën të përdoret në gjuhën tonë.